




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 52, par.1 dhe 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 46 i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe nenit 12; par.1,2,3,4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Kryesuesja e Kuvendit:

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, e cila mbahet me datën 21.02.2024 (ditë e mërkurë) me fillim në orën 14:00, në Sallën e Bordit të Drejtorëve

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, znj. Blerta Dobra-Geci);
5. Të ndryshme.




KRYESUESI E KUVENDIT
znj. Adalina Spahiu

ASpahi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë **23.01.2024**, në ora **11:00**, në sallën e bordit të drejtoreve.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, me Nr.02-463/04-003326/24, e datës 16.01.2024 (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
Pikat shtesë për këtë rend dite:
5. Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, me Nr.02-052/01-0004333/24, të datës 23.01.2024, (Raporton Drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
6. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022, me Nr.03-052/01-0003794/24, të datës 18.01.2024, (Raporton Koordinatori Komunal i Performancës **z. Mirsad Gashi**);
7. Të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar anëtar KPF-së, Drejtor të Drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë të KPF-së, mungon pa arsye Fatbardha Haliti-Mustafa dhe Floriana Halili, Para miratimit të rendit të ditës i kemi dy pika shtesë:

1. Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, me Nr.02-052/01-0004333/24, të datës 23.01.2024.

2. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022, me Nr.03-052/01-0003794/24, të datës 18.01.2024.

Shkojmë në votim, për futjen në rend dite, të pikës së parë, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim, futet në rend dite, Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022.

Shkojmë në votim, për futjen në rend dite, të pikës së dytë, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023.

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, Nr.02-463/04-003326/24, datës 16.01.2024 (Raporton),

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, procedurë e iniciuar me kërkesë të personit fizik Mujë Hoti, e cila në vazhdimësi nga viti 2021 ka bërë kërkesë për kompensimin e pronës që ju ka marrë për realizimin e projektit për zgjerimin e rrugës Morinë-Rezallë, prona e cila propozohet të këmbëhet janë ngatrrat nr.595-0, me sip. 1109m², nga sipërfaqja e përgjithshëm 23503m², dhe ngastra Nr.600-0, me sipërfaqe 767m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7596m², që në total për këmbim propozohet sipërfaqja 1876m². Më pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti ngastra Nr.208-0 me sipërfaqe 1876m² nga sipërfaqja e përgjithshëm 8055m², ju ftoj me përkrah.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, Konstatohet me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, me Nr.02-052/01-0004333/24, të datës 23.01.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Fjala përshëndetëse, e kërkoj mirëkuptimin e juaj që këtë raport e kam sjellë si pikë shtesë, është një raport mjaft voluminoz që kërkon të dhëna statistikore shume, dhe ligjërisht afati kohorë e ka deri me 31 mars, po për shkak të kriterit të performancës kërkohet të raportohet në janar, të gjitha të dhënat janë të sakta dhe sot kam arritur me protokollua dhe e kam sjellë para jush ju ftoj me përkrah, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Ilir Ejupi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, Të lloji i shpenzimeve, sipas kategorive: Të shpenzimet mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve shuma 62,817.12€, ne e dimë së kemi blerë vetura të reja, pse ky shpenzim kaq i madh? Dhe të Shpenzimi Mirëmbajtja e mobileve she pajisjeve shuma 62,144.73€, çfarë pajisje keni mirëmbajt me këto shpenzime?

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Të shpenzimet mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve shuma 62,817.12€, është një shume pak me e lartë së e viteve tjera edhe pse këtë vite jemi furnizua me vetura të reja, po ky shpenzim është për gjitha veturat diku 50 automjete, duke përfshirë Administratën komunale, shëndetësinë arsimin, po edhe zjarrfikëset, janë furnizua me dy palë goma dhe vite në vazhdim nuk do të kemi këtë shpenzim. Të Shpenzimi Mirëmbajtja e mobileve she pajisjeve shuma 62,144.73€, këto shpenzime janë rrethe mirëmbajtjes së klimave, dritave të komunës, mirëmbajtja e aparateve të analizave në QKMF, servsimi i kaldajajt dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet.

Kryesuesja: Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatohet me (4) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, me Nr.02-052/01-0004333/24, të datës 23.01.2024.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

-Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022, me Nr.03-052/01-0003794/24, të datës 18.01.2024, (Raporton):

Koordinatori Komunal i Performancës, Mirsad Gashi; Fjala përshëndetëse, para jush si pikë shtesë e keni Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022, nëse e keni lexua kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Ilir Ejupi-IDEAL: Mirsad, a e keni bënë ndonjë krahasim nëpër vite për performancë komunale?

Koordinatori Komunal i Përformancës, Mirsad Gashi; Për vitin 2021 nuk kemi raportua fare, për vitin 2020 kemi qenë nder komunat e para për arsye së jemi pajisur me i-kioska dhe e kemi nxjerre HZK, dhe Planin e Integritetit komunal, qe i kemi bë nder komunat e para.

Kryesuesja: Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Shqyrtimi i Raportit të përformancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës; Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, me datë 31.01.2024, ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ SHKUPË NADREPTINE SKENDERAJ	
Nr.	
No.	05-020/01-0009631/24
Data.	
Data.	13.02.2024



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

DATË/A:	13/02/2024
REFERENC-Ë	
PËR/ZA/TO	Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës së Skenderajt, Kryesueses znj. Adelina SPAHIU
NGA OD/FROM:	Drejtoresha e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, Skenderaj znj. Blerta Dobra-Geci
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë

Të nderuar,

Kuvendi i Rep. së Kosovës në seancën e jashtëzakonshme të datës 14.12.2023 ka votuar në lexim të dytë Ligjin Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme i cili tashmë është bërë i plotfuqishëm. Ky Ligj shënon një reforme rrënjësore në Sektorin e Kadastrit dhe Gjeodezisë, unifikon legjislacionin nga fusha e Kadastrit, definojnë në plotëni organizimin vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrave Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, fuqizon rolin e Komisionit për Rindërtimin e informacioneve kadastrale, krijon më shumë mundësi për qasje më të lehtë të institucioneve dhe publikut në informacione Kadastrale etj.

Nga ky organizim vertikal institucional sipas Ligjit të ri do të shkëputen dy sektorët kryesor nga Drejtoria e GJKP-së sektorit të Kadastrit dhe Gjeodezisë ku si ZKK do të përfshihen në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës d.m.th do të jenë nën menaxhimin e AKK-së duke ndjekur një praktikë të bazuar në sistemin kadastral të shteteve të rajonit e më gjerë.

Ky organizim rrit besueshmërinë e qytetarëve në institucione, meqë shkurton rrugën për kërkimin e përgjegjësisë nga niveli lokal në atë qendrorë, dhe do të marrin shërbime me efikasitet dhe më të shpejta.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Kadastrin e pronës së Paluajtshme do të trajtohet një nga problemet më të theksuara në të drejtën pronësore që është informaliteti i lartë. Formalizimi i të drejtave pronësore është

synim parësor në sektorin e të drejtave pronësore pasi që të drejtat pronësore të pa formalizuara mbesin jashtë qarkullimit juridik, e kjo do të realizohet përmes fuqizimit të rolit Komisionit për Rindertimin e informacioneve kadastrale i definuar me këtë Ligj.

Agjencia Kadastrale e Kosovës tashmë ka formuar grupin e saj punues ku në bashkëpunim me të gjitha Komunitat janë në përfundim të Udhëzimeve Administrative për implementimin e këtij Ligji, ku në total do të jenë 14 Udhëzime Administrative të derivuara nga ky Ligj.

I gjithë stafi ekzistues i Zyres Komunale Kadastrale do të jetë nën menaxhim të Agjencisë edhe pse do të mbesin me lokacion në kuadër të Institucionit të Komunës për të ofruar shërbime sa më të lehta dhe më të mira Kadastrale qytetarëve të territorit administrativ të Komunës së Skenderajt mirëpo puna dhe detyrat e tyre do të menaxhohen nga AKK-ja.

Për tërë këtë organizim vertikal, organizim të menaxhimit të punëtorëve dhe çështje tjera me rëndësi do të nënshkruhen marrëveshje të veçanta mes Komunës dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Institucioni i Komunës do të ketë humbje të të hyrave nga centralizimi i këtij sektori, mirëpo qytetari është ai që do të përfitojë nga ndryshimi rrënjësor i sistemit të gjertanishëm Kadastral.

Me respekt!